



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 15, datë 02.04.2026



PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË NJËSIVE
ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1.1, shkronjës “b”, nenit 54, shkronjës “ç”, nenit 55, pikës 2, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjit 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 113 të Ligjit 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.776, datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Vendimit nr.103, datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufjeve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesem 2026-2028”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e nivelit të pagave të Njësive Administrative të Bashkisë Durrës sipas lidhjeve nr.1, nr.2, nr. 3, nr.4 dhe nr.5, si më poshtë vijon:

Lidhja nr.1

Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 5.001-20.000 banorë (Njësitë Administrative Manëz, Ishëm, Katund i Ri)

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Kategoria/klasa	Shtesa e nivelit të kualifikimit (Grupi i diplomës)	Paga për pozicion (lekë në muaj)	Shtesa për vjetërsi (sipas pikës ç të VKM nr.503 dt.1.8.2024)
1	Administrator	-	-	148.625	
2	Specialist	IV-3	1/2/3	75.000	

Lidhja nr.2

Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 20.001 – 50.000 banorë (Njësitë Administrative nr. 1, nr. 2, nr.3, nr. 6, Sukth, Rrashbull)

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Kategoria/klasa	Shtesa e nivelit të kualifikimit (Grupi i diplomës)	Paga per pozicion (lekë në muaj)	Shtesa për vjetërsi (sipas pikës ç të VKM nr.503 dt.1.8.2024)
1	Administrator	-	-	158.875	
2	Specialist	IV-3	1/2/3	75.000	

Lidhja nr. 3

Niveli i pagave në Njësitë Administrative me 50.001 – 100.000 banorë (Njësitë Administrative nr. 4, nr.5)



Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Kategoria/klasa	Shtesa e nivelit të kualifikimit (Grupi i diplomës)	Paga për pozicion (lekë në muaj)	Shtesa për vjetërsi (sipas pikës ç të VKM nr.503 dt.1.8.2024)
1	Administrator	-	-	184.500	-
2	Specialist/inspektor	IV-3	1/2/3	75.000	

Shtesa për vjetërsi në punë për lidhjen nr.1,2,3, për pozicionin Specialist, të jepet jepet në masën :

- i. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- ii. 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- iii. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Lidhja nr. 4

Niveli i pagave për punonjësit administrativë të Njësive Administrative

Nr.	Emërtimi I pozicionit të punës	Shtesa për vjetërsi	Paga bazë (lekë në muaj)	Shtesa për kushte pune
2	Pastrues, roje	1%	52.000	4.000

Shtesa për vjetërsi në punë për lidhjen nr.4 të jepet në masën 1% pas cdo vit pune, deri në 25 vjet dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

Lidhja nr. 5

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i Shkencave. Master i Arteve; Master Profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike; Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14,000
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master Profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12,000
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor).	10,000



2. Miratimin e Shpërblimit mujor të kryetarëve të fshatrave sipas tabelës së mëposhtëme:

Treguesi	Nr popullsisë	Niveli i pagës
Njësia		
Njësia Administrative Sukth	31,731	15,500.00
Njësia Administrative Manëz	12,897	14,500.00
Njësia Administrative Ishëm	9,689	14,500.00
Njësia Administrative Katund i Ri	17,228	14,500.00
Njësia Administrative Rrashbull	38,376	15,500.00

3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar 2026 dhe do të përballohen nga fondi rezervë për rritjen e pagave i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2026.
4. Ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Buxhetit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 03.04.2026



BASHKIA DURRES
09/4/26 4185/4
PROT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRES

Nr. 246/5 prot.

Durrës, më 08.04.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRES**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRES**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.15 datë 02.04.2026 ,” Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të njësive administrative të Bashkisë së Durrësit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

